FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 79

Tiranë – E hënë, 4 maj 2020

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.344, datë 29.4.2020	Për kalimin në pronësi të Bashkisë Elbasan, për njësinë administrative Labinot-Fushë, të sipërfaqes prej 18493 m^2, e llojit e pafrytshme, me vendndodhje në zonën kadastrale 2355	4405
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.345, datë 29.4.2020	Për procedurat për emërimin dhe trajtimin financiar të nëpunësve të emëruar nga institucionet e tjera në misionet diplomatike të Republikës së Shqipërisë	4407
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.346, datë 29.4.2020	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Drejtësisë tek Agjencia Shtetërore e kadastrës, për pronat e përcaktuara në vendimin nr.411, datë 29.8.2002, të Këshillit të Ministrave, "Për kalimin e disa mjediseve në administrimin e zyrës qendrore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Tiranë, Korçë dhe Durrës", të ndryshuar	4408
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.347, datë 29.4.2020	Për transferimin në pronësi të bashkisë Tiranë, të njësisë administrative Tiranë, të pronës me emërtimin "Uzina e pjesëve të ndërrimit të automjeteve", me vendndodhje në zonën kadastrale 8170	4408
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.348, datë 29.4.2020	Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes nëpërmjet vetëpunësimit	4415
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.350, datë 29.4.2020	Për transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë "Trajtimi i studentëve", sh.a., Shkodër, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë te Bashkia Shkodër	4417
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.351, datë 29.4.2020	Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2020, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë	4418

Vendim i Këshillit të Ministrave nr.353, datë 29.4.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.327, datë 28.5.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e formatit dhe mënyrës së mbledhjes e të raportimit të të dhënave nga ofruesit e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, publik ose privat".....	4418
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.354, datë 29.4.2020	Për dhënien e ndihmës me personel infermier për Republikën e Italisë.	4419
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.356, datë 26.2.2020	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Drejtësisë te Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për ndërmarrjen industriale nr.1 Tiranë, të pasurisë nr.1/645, zona kadastrale nr.8210, Tiranë, dhe miratimin e projektkontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr.1/645/nd, zona kadastrale 8210, Tiranë, për qëllim të zbatimit të Programit të Integruar të Zhvillimit "Poli i Drejtësisë".....	4419
Vendim i Komitetit Ndërministror të Emergjencave Civile nr.16, datë 28.4.2020	Për dhënien e ndihmës me personel infermier për Republikën e Italisë.	4420

VENDIM
Nr. 344, datë 29.4.2020

PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË ELBASAN, PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE LABINOT-FUSHË, TË SIPËRFAQES PREJ 18493 M^2, E LLOJIT E PAFRYTSHME, ME VENDNDODHJE NË ZONËN KADASTRALE 2355

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 dhe 17, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të Bashkisë Elbasan, për njësinë administrative Labinot-Fushë, të sipërfaqes prej 18 493 m^2, me vendndodhje në zonën kadastrale 2355, me qëllim për t'u përdorur në fushën e zhvillimit ekonomik dhe social, sipas formularit gjithsej 1 (një) fletë dhe hartës kadastrale, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Ngarkohen Bashkia Elbasan dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Bashkia Elbasan

Identifikoi: Specialist Gjeodet: Elior Mihali
Supervizoi: Dr. Aseteve ,pronave dhe Strehimit: Arba Suli
Aprovoi: Kryetari Bashkisë Gledian Llatja

Fusha e perdorimit te Prones: Zhvilim ekonomik

	A			B			C			
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones m2	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	2355 K-34-101-(150-A) Shkalla:1:2500 K-34-101-(149-B)	1	PF (E pafrytshme)	Bashkia Elbasan / Njësia Adm Labinot -Fushë	18493 m2	0	E papërdorur	Pa varësi administrative	Pa varësi administrative	Tokë e paregjistruar. Shërben për regjistrimin fillestar të pronës.

HARTE KADASTRALE
(Fragment)

Drejtoria e Perpilimit te Detyrave te Projektimit
Standartizimit dhe Azhornimit te Tokave
Bashkia Elbasan
Emri: Ing. Gjeodet Elior Mihali
Miratoi:Drejtori.ark.Raimond Hazballa

KRYETARI BASHKISE ELBASAN

GLEDIAN LLATJA

A. IDENTIFIKIMI I PASURISË

ZONA KADASTRALE: 2355 NR.I.PASURISË: 1 Vol __ Fq ____

INDEKSI I HARTËS:K-34-101-(150-A) SHKALLA: 1:2500
K-34-101-(149-B)

ADRESA E PASURISË: Labinot Fushe O/F Elbasan
Rr_____ P/G SH K AP

B. KUFIZIMET

VERI: are
JUG: prita / l.shkumbin
LINDJE: argjinature
PERENDIM: perrua / l.shkumbin

C. PRONARI

Data pergatitjes: 15/01/2020

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE KRGJSH



LEGJENDË	
1	X: 512859.877 m Y: 4555733.181 m
2	X: 513004.991 m Y: 4555813.573 m
3	X: 513065.523 m Y: 4555711.689 m
4	X: 512953.207 m Y: 4555664.213 m
5	X: 512832.255m Y: 4555664.213 m

Siperfaqa(1) 18493 m2

VENDIM
Nr. 345, datë 29.4.2020

PËR PROCEDURAT PËR EMËRIMIN DHE TRAJTIMIN FINANCIAR TË NËPUNËSVE TË EMËRUAR NGA INSTITUCIONET E TJERA NË MISIONET DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 31, të ligjit nr.23/2015, "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Emërimi në misionet diplomatike, sipas pikës 2, të nenit 31, të ligjit nr.23/2015, "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", bëhet pas koordinimit të ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme me institucionin që propozon nëpunësin, më poshtë referuar si "institucioni dërgues".

2. Institucioni dërgues propozon emërimin e nëpunësit sipas pikës 1, të këtij vendimi, duke e përzgjedhur atë nëpërmjet procedurave të brendshme të institucionit.

3. Këta nëpunës emërohen nga ministri përgjegjës për punët e jashtme, me propozim të ministrit të institucionit dërgues dhe janë në varësi të dyfishtë, nga kreu i misionit diplomatik dhe titullari i institucionit dërgues.

4. Përshkrimi i punës, hierarkia, mënyra e komunikimit dhe të drejtat e detyrimet e palëve përcaktohen në marrëveshjen e lidhur ndërmjet ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme dhe institucionit dërgues. Marrëveshja duhet të përmbajë:

a) pozicionin e punës/gradën diplomatike të emërimit;

b) varësinë e dyfishtë nga kreu i misionit diplomatik dhe titullari i institucionit dërgues;

c) përshkrimin e punës;

ç) afatin e punësimit;

d) të drejtat dhe detyrimet e nëpunësit;

dh) të drejtat dhe detyrimet e ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme dhe të institucionit dërgues.

5. Nëpunësit do të shërbejnë në misionin diplomatik sipas afatit të përcaktuar në ligjin për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë dhe pas përfundimit të këtij shërbimi do të rikthehen në pozicionin e mëparshëm ose në një pozicion të barasvlershëm me të.

6. Me emërimin e nëpunësve në misionin diplomatik, marrëdhënia e tyre e punës do të rregullohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e punës në shërbimin e jashtëm.

7. Nëpunësit e emëruar në përputhje me pikën 1, të këtij vendimi, trajtohen sipas pagës referuese të gradës diplomatike të emërimit, në përputhje me vendimet e Këshillit të Ministrave, nr.546, datë 11.8.2011, "Për përcaktimin e pagave dhe shtesave mbi pagë të punonjësve të përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja, të atasheve ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe nr.20, datë 18.1.2017, "Për mbulimin e shpenzimeve financiare të personelit të shërbimit të jashtëm dhe familjarëve që i shoqërojnë ata gjatë kohës që dërgohen me shërbim në misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit".

8. Shpenzimet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i institucionit dërgues.

9. Nga zbatimi i këtij vendimi përjashtohen nëpunësit emërimi i të cilëve në misionet diplomatike të Republikës së Shqipërisë rregullohet me akte të tjera nënligjore.

10. Ngarkohen ministria përgjegjëse për punët e jashtme dhe të gjitha institucionet shtetërore, që brenda fushës së tyre të përgjegjësisë dërgojnë nëpunës për t'i emeruar në misionet diplomatike, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 346, datë 29.4.2020

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E DREJTËSISË TEK AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS, PËR PRONAT E PËRCAKTUARA NË VENDIMIN NR.411, DATË 29.8.2002, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KALIMIN E DISA MJEDISEVE NË ADMINISTRIMIN E ZYRËS QENDRORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME DHE TË ZYRAVE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TIRANË, KORÇË DHE DURRËS", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 7, 13, 14 dhe 15, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të neneve 6 e 7, të ligjit nr.111/2018, "Për kadastrën", me propozimin e Zëvendëkryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Drejtësisë tek Agjencia Shtetërore e Kadastrës, për pronat e përcaktuara në vendimin nr.411, datë 29.8.2002, të Këshillit të Ministrave, "Për kalimin e disa mjediseve në administrimin e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Tiranë, Korçë dhe Durrës", të ndryshuar.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 347, datë 29.4.2020

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË, TË NJËSISË ADMINISTRATIVE TIRANË, TË PRONËS ME EMËRTIMIN "UZINA E PJESËVE TË NDËRRIMIT TË AUTOMJETEVE", ME VENDNDODHJE NË ZONËN KADASTRALE 8170

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, 5, 8 dhe 17, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të njësisë administrative Tiranë, të pronës me nr.16, me emërtimin "Uzina e pjesëve të ndërrimit të automjeteve", me vendndodhje në zonën kadastrale 8170, sipas formularëve gjithsej 3 (tre) fletë dhe hartave kadastrale, bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim për t'u përdorur në fushën e strehimit dhe të shërbimeve sociale.

2. Prona e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohet listës përfundimtare të pjesshme të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.219, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pjesshme (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të njësisë administrative Tiranë, Bashkia Tiranë, të Qarkut të Tiranës", të ndryshuar.

3. Bashkisë Tiranë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve pronën e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Bashkia Tirane

Identifikoi:
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Supervizoi:
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi:
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

Fusha e perdorimit te Prones: Zhvillim ekonomik

Nr. Renc	A			B			C			
	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones m2	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
16	8170 TR O-20,21 TR N-20,21	10/280	Truall	UPNA Rruga "Ali Shefqeti" Tirane	27124	13437	Prodhim	Bashkia Tirane	UPNA	v14 fq152
	8170 TR N- 20	10/278	Shesh	UPNA Rruga "Ali Shefqeti" Tirane	2006	842	Prodhim	Bashkia Tirane	UPNA	v 14 fq 154 Ish Uzina Autotraktoreve
	8710 TR N- 21	10/300	Truall	UPNA Rruga "Ali Shefqeti" Tirane	2097.2	1181.2	Prodhim	Bashkia Tirane	UPNA	v 18 fq 216 Ish Uzina Autotraktoreve
	8170 TR O-21 TR N-21	10/302	Truall	UPNA Rruga "Ali Shefqeti" Tirane	28521	9965.8	Prodhim	Bashkia Tirane	UPNA	v 18 fq 218 Ish Uzina Autotraktoreve
	8170 TR N- 20	10/261	Truall	UPNA Rruga "Ali Shefqeti" Tirane	64		Prodhim	Bashkia Tirane	UPNA	v 15 fq 58 Ish Uzina Autotraktoreve

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
	8170 TR N- 20	10/262	Truall	UPNA Rruga "Ali Shefqeti" Tirane	19		Prodhim	Bashkia Tirane	UPNA	v 15 fq 59 Ish Uzina Autotraktoreve
	8170 TR N- 20	10/260	Truall	UPNA Rruga "Ali Shefqeti" Tirane	87		Prodhim	Bashkia Tirane	UPNA	v 15 fq 57 Ish Uzina Autotraktoreve
	8170 TR N- 20	10/259	Truall	UPNA Rruga "Ali Shefqeti" Tirane	191		Prodhim	Bashkia Tirane	UPNA	v 15 fq 56 Ish Uzina Autotraktoreve Ka ndertim pa leje te vetdeklaruar.
	8170 TR N- 20	10/258	Truall	UPNA Rruga "Ali Shefqeti" Tirane	21		Prodhim	Bashkia Tirane	UPNA	v 15 fq 55 Ish Uzina Autotraktoreve
	8170 TR O-20	10/257	Truall	UPNA Rruga "Ali Shefqeti" Tirane	118		Prodhim	Bashkia Tirane	UPNA	v 15 fq 54 Ish Uzina Autotraktoreve
	8170 TR N- 20	10/274	shesh	UPNA Rruga "Ali Shefqeti" Tirane	549		Prodhim	Bashkia Tirane	UPNA	v 14 fq 158 Ish Uzina Autotraktoreve
	8170 TR N- 20	10/275	Truall	UPNA Rruga "Ali Shefqeti" Tirane	680	680	Prodhim	Bashkia Tirane	UPNA	v 14 fq 157 Ish Uzina Autotraktoreve
	8170 TR N- 20	10/276	Truall	UPNA Rruga "Ali Shefqeti" Tirane	239	239	Prodhim	Bashkia Tirane	UPNA	v 14 fq 156 Ish Uzina Autotraktoreve

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
	8170 TR N- 20	10/273	Shesh	UPNA Rruga "Ali Shefqeti" Tirane	1086		Prodhim	Bashkia Tirane	UPNA	v 14 fq 159 Ish Uzina Autotraktoreve
	8170 TR N- 20	10/318	Truall	UPNA Rruga "Ali Shefqeti" Tirane	85.14		Prodhim	Bashkia Tirane	UPNA	Ish Uzina Autotraktoreve


HARTE KADASTRALE
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORI I PËRGJITHSHËM
ARTAN LAME
A.IDENTIFIKIMI I PASURISË
ZONA KADASTRALE: 8170 NR.E PASURIVE: 10/278, 10/280, 10/261, 10/262
10/260,10/259, 10/258, 10/318
INDEKSI I HARTËS: TR; O-20-21, TR; N-20-21 SHKALLA: 1:500
ADRESA E PASURISË: TIRANË Q/F TIRANË
RR. P/G SH K AP
B. KUFIZIMET
VERI:
JUG:
LINDJE:
PERENDIM:
Data: 12.02.2020
Ora:
C. PRONARI
SHTET
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE KRGJSH
8170
TIRANE
10/278
10/280
10/261
10/262
10/260
10/259
10/318
10/258
10/305
10/316
10/279
10/95
10/257
10/94
10/20
10/276
10/275
10/31
10/274
10/298
10/290
10/291
10/300
10/304
10/287
10/288
12/218
12/219
12/220/221
12/298
12/222
12/223
12/224
12/299
12/300
Pika X(m) Y(m)
9 488912.1 4577498.5
10 489053.9 4577467.3
11 489032.9 4577313.3
12 489000.1 4577320.5
13 488992.6 4577287.3
14 488888.2 4577315.3
15 488864.0 4577426.6
16 488853.3 4577443.7
Shenime:
Pasuritë objekt i VKB nr.10, datë 31.01.2018
10/278, 10/280, 10/261, 10/262, 10/260, 10/259, 10/258, 10/318, 10/300, 10/302, 10/257, 10/274, 10/275, 10/276, 10/273


HARTE KADASTRALE
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORI I PËRGJITHSHËM
ARTAN LAME
Njësia e Kadastrës dhe Hartografisë
Drejtor: Andi PROKO
A. IDENTIFIKIMI I PASURISË
ZONA KADASTRALE: 8170 NR.E PASURIVE: 10/300, 10/302
INDEKSI I HARTËS: TR; O-20-21, TR; N-20-21 SHKALLA: 1:500
ADRESA E PASURISË: TIRANË Q/F TIRANË
RR. P/G SH K AP
B. KUFIZIMET
VERI:
JUG:
LINDJE:
PERENDIM:
Data: 12.02.2020
C. PRONARI
SHTET
Ora:
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE KRGJSH
8170
TIRANE
10/280
10/288
10/300
10/302
10/304
10/283
10/284
10/285
10/286
10/289
12/250
12/254
12/264
Pika X(m) Y(m)
1 489060.9 4577442.1
2 489132.6 4577434.5
3 489177.2 4577425.1
4 489188.3 4577438.3
5 489280.7 4577418.0
6 489193.4 4577234.0
7 489118.1 4577399.5
8 489054.5 4577412.8
Shenime: Pasuritë objekt i VKB nr.10, datë 31.01.2018
10/278, 10/280, 10/261, 10/262, 10/260, 10/259, 10/258, 10/318, 10/300, 10/302, 10/257, 10/274, 10/275, 10/276, 10/273


HARTE KADASTRALE
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORI I PËRGJITHSHËM
ARTAN LAME
Njësia e Kadastrës dhe Hartografisë
Drejtor Andi PROKO
A. IDENTIFIKIMI I PASURISË
ZONA KADASTRALE: 8170 NR.E PASURIVE: 10/257, 10/274, 10/275, 10/276, 10/273
INDEKSI I HARTËS: TR; O-20-21, TR; N-20-21 SHKALLA: 1:500
ADRESA E PASURISË: TIRANË Q/F TIRANË
RR. P/G SH K AP
B. KUFIZIMET
VERI:
JUG:
LINDJE:
PERENDIM:
Data: 12.02.2020 Ora:
C. PRONARI
SHTET
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE KRGJSH
TIRANE
10/290
10/278
10/280
10/261
10/262
10/260
10/259
10/318
10/258
10/305
10/316
10/94
10/279
10/95
10/257
10/20
10/276
10/277
10/275
10/274
10/31
10/298
10/273
17
18
19
20
21
22
23
Pika X(m) Y(m)
17 488779.5 4577444.4
18 488827.2 4577419.9
19 488847.5 4577364.9
20 488863.9 4577331.2
21 488755.5 4577369.2
22 488698.7 4577411.2
23 488717.9 4577422.0
Shenime: Pasuritë objekt i VKB nr.10, datë 31.01.2018
10/278, 10/280, 10/261, 10/262, 10/260, 10/259, 10/258, 10/318, 10/300, 10/302, 10/257, 10/274, 10/275, 10/276, 10/273

VENDIM
Nr. 348, datë 29.4.2020

PËR PROCEDURAT, KRITERET DHE RREGULLAT PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT TË NXITJES NËPËRMJET VETËPUNËSIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 11, të ligjit nr.15/2019, "Për nxitjen e punësimit", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton kriteret, procedurat dhe rregullat për zbatimin e programit të vetëpunësimit, i cili ka si qëllim nxitjen e vetëpunësimit nëpërmjet krijimit të sipërmarrjeve të reja të punëkërkuesve të papunë të interesuar.

2. Programi i vetëpunësimit është program njëvjeçar për mbështetjen e sipërmarrjeve të reja, nëpërmjet të cilit ofrohet trajnim për sipërmarrjen dhe zhvillimin e planeve të biznesit për aplikuesit dhe grant për përfituesit.

3. Fondi i nxitjes së punësimit për programin sipas pikës 1, të këtij kreu, mbulon shpenzimet për:

a) grantin për hapjen e biznesit të ri;

b) vlerësimin e planeve të biznesit.

4. Ky program zbatohet bazuar në një proces të drejtë dhe konkurrues aplikimi.

5. Ky program zbatohet dhe administrohet nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA).

6. AKPA-ja, sipas nevojës, mund të kontraktojë subjekte të tjera publike, private apo organizata të shoqërisë civile, veprimtaria e të cilave është e lidhur me fushën e punësimit, për të bërë të mundur zbatimin me cilësi dhe në kohë të programeve të nxitjes së punësimit, sipas legjislacionit në fuqi.

II. KRITERET E APLIKIMIT, PËRFITUESIT DHE MBËSHTETJA

1. Për të aplikuar në këtë program, aplikuesi duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) Është punëkërkues i papunë i regjistruar në strukturën vendore të punësimit;

b) Ka një ide biznesi, e cila nuk është në kundërshtim me kriteret e konkurrueshmërisë, të përcaktuara në dispozitat e Kodit të Punës dhe që deklarohet në bazë të një formulari të posaçëm, i cili përmban:

i. përshkrimin e idesë së biznesit;

ii. relevancën (rëndësinë);

iii. burimet e nevojshme për realizimin e biznesit;

iv. vlerësimin e gjendjes së mjediseve ku do të zhvillohet biznesi.

2. Punëkërkuesi, i cili aplikon në këtë program, duhet të marrë pjesë personalisht në të gjitha hallkat e procesit.

3. Një punëkërkues mund të përfitojë vetëm një herë nga ky program.

4. Shpenzimet për vlerësimin e planit të biznesit të të gjithë pjesëmarrësve, në vlerën jo më shumë se 3 000 (tre mijë) lekë për çdo plan biznesi, sipas çmimeve të tregut për këtë lloj ekspertize, mbulohen nga AKPA-ja, nga zëri i buxhetit "Programet e nxitjes së punësimit".

5. Programi subvencionon për të gjithë të përzgjedhurit si përfitues grantin për ngritjen e biznesit deri në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

6. Shpenzimet që nuk mund të mbulohen nga granti i financuar janë:

a) blerja e pasurive të patundshme;

b) çdo shpenzim që nuk lidhet dhe nuk përfshihet në planin e biznesit të miratuar;

c) shpenzimet e kryera përpara nënshkrimit të marrëveshjes së grantit;

ç) pagat, shpërblimet, qiraja dhe shpenzimet e tjera administrative.

III. RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR PËRFITIMIN E PROGRAMIT TË VETËPUNËSIMIT

1. AKPA-ja, nëpërmjet strukturave të saj, publikon informacionin e nevojshëm në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në platforma të tjera në lidhje me zbatimin e programit dhe zhvillon një fushatë informuese për aplikim për të gjithë personat e interesuar, për mundësinë e pjesëmarrjes si dhe për kriteret e procedurat e aplikimit.

2. Afati për të aplikuar në program, për të gjithë punëkërkuesit e papunë, është 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e shpalljes së thirrjes.

3. Punëkërkuesi duhet të paraqesë pranë strukturës përkatëse të punësimit ose të ngarkojë në mënyrë elektronike dokumentet e mëposhtme:

a) Formularin e aplikimit, i cili duhet të përmbajë:

i. projektidenë e detajuar të biznesit;

ii. vetëdeklarimin mbi plotësimin e kushteve të programit dhe marrjen e përgjegjësisë në rastet e deklarimeve të rreme;

iii. deklaratë për të autorizuar strukturën përkatëse të punësimit të kërkojë apo të gjenerojë on-line dokumentacionin e nevojshëm për verifikimet e përputhshmërisë.

b) Vërtetimin që personi nuk ka detyrime tatimore;

c) Kopjen e dokumentit identifikues.

4. Struktura vendore e punësimit verifikon plotësimin e kushteve formale paraprake të aplikimit dhe përputhshmërinë e tij me rregullat e zbatimit të këtij programi dhe, brenda 5 (pesë) ditëve pune, dërgon në strukturën rajonale të punësimit listat e aplikantëve, që i kanë përmbushur këto kushte.

5. Struktura rajonale e punësimit, në bashkëpunim me ofruesit e arsimit dhe formimit profesional, harton, brenda 5 (pesë) ditëve pune, planin e zhvillimit të trajnimit për sipërmarrjen dhe zhvillimin e planeve të biznesit.

6. Brenda 10 (dhjetë) ditëve pune duhet të fillojë trajnimi në ofruesit e AFP-së.

7. Kohëzgjatja e trajnimit është 3 (tre) javë kalendarike dhe në përfundim të trajnimit zhvillohet testim me shkrim.

8. Pjesëmarrësit, të cilët kalojnë me sukses testimin me shkrim, dorëzojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të APKA-së, brenda 7 (shtatë) ditëve pune, planin e biznesit. Plani i biznesit përmban një seksion specifik me të gjitha shpenzimet e domosdoshme për themelimin e biznesit. Secili prej zërave të shpenzimeve duhet të specifikojë burimin përkatës të financimit nga ky program ose burime të tjera, për të cilat duhet të bashkëlidhë dokumentacionin vërtetues.

9. Vlerësimi i planeve të biznesit realizohet, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune, nga AKPA-ja, në dy faza:

a) Vlerësimi i planit të biznesit nga ekspertë të jashtëm të fushës mbi bazën e këtyre kritereve:

i. Realizueshmëria financiare e projektit;

ii. Burimet në dispozicion për themelimin e biznesit;

iii. Njohja e llojit përkatës të biznesit;

iv. Vlerësimi i tregut.

b) Procesi i vlerësimit nga komisioni i ngritur në Drejtorinë e Përgjithshme të AKPA-së përfshin hapat e mëposhtëm:

i. Zbatimin e procedurës në bazë të rregullores përkatëse;

ii. Bën renditjen e aplikuesve në varësi të pikëve;

iii. Shqyrton mundësitë e financimit dhe bën renditjen sipas pikëve dhe mundësive të financimit.

10. Komisioni për vlerësimin e planit të biznesit ngrihet me fillimin e procesit të këtij programi dhe përbëhet nga tre anëtarë, si më poshtë vijon:

a) Një përfaqësues nga AKPA-ja;

b) Një përfaqësues nga Drejtoria Rajonale;

c) Një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për punësim.

11. Përzgjedhja e anëtarëve të këtij komisioni bëhet, si më poshtë vijon:

a) Përfaqësuesi i ministrisë caktohet nga ministri përkatës;

b) Përfaqësuesi i AKPA-së dhe i Drejtorisë Rajonale do të caktohen nga drejtori i Përgjithshëm i institucionit.

12. Mënyra e organizimit, e vlerësimit të projekteve, e funksionimit të punës, e informimit si dhe përbërja e komisionit përcaktohen në rregulloren e zbatimit të programeve të nxitjes së punësimit.

13. Drejtoria e Përgjithshme e AKPA-së shpall listën e fituesve nëpërmjet strukturave vendore të punësimit dhe njofton njëkohësisht strukturat rajonale të punësimit për ndjekjen e procedurave në vijim.

14. Aplikuesit e përzgjedhur duhet të regjistrojnë, brenda 5 (pesë) ditëve pune, sipërmarrjet e reja në Qendrën Kombëtare të Biznesit, të hapin një llogari bankare për biznesin dhe të depozitojnë te struktura rajonale e punësimit dokumentet provuese.

15. Pas dorëzimit të këtyre dokumenteve, struktura rajonale e punësimit dhe çdo përfitues nënshkruajnë kontratën për përfitimin e grantit.

16. Financimi bëhet në këto faza:

a) Me nënshkrimin e kontratës, përfituesit i transferohen si paradhënie në llogarinë e biznesit 20% e vlerës së grantit, shumë të cilën përfituesi duhet ta justifikojë me fatura të rregullta tatimore dhe vërtetim të kryerjes së pagesave, si kusht për financimin e pjesës së mbetur të grantit;

b) Vlera e mbetur e grantit i rimbursohet deri në dy këste, të justifikuara me fatura të rregullta tatimore dhe vërtetimin e kryerjes së këtyre pagesave.

c) Vlera e plotë e grantit duhet të shpenzohet brenda katër muajve nga lidhja e kontratës me strukturën rajonale të punësimit;

ç) Përfituesit nuk duhet të shkelin asnjë nga kushtet e kontratës për përfitimin e grantit dhe zbatimin e programit. Nëse përfituesit shkelin kushtet e kontratës, përfituesi është i detyruar të kthejë 100% të mbështetjes financiare të përfituar deri në atë moment.

17. Monitorimi i zbatimit të programit kryhet nga strukturat përkatëse të punësimit.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit përcakton çdo vit prioritetet për programet e nxitjes së punësimit sipas zonave gjeografike, sektorëve ekonomikë dhe nevojave të punëkërkuesve dhe miraton planin e zbatimit të fondeve të nxitjes së punësimit, pas propozimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. AKPA-ja njofton periodikisht ministrinë përgjegjëse për çështjet e punësimit për ecurinë e programit.

2. AKPA-ja përgatit raportin vjetor brenda datës 31 mars të vitit pasardhës dhe ia paraqet ministrisë përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe strukturës përgjegjëse të ndihmës shtetërore.

3. AKPA-ja ruan të dhënat për programet për 10 (dhjetë) vjet, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

4. Vlerësimi i ndikimit të programeve kryhet çdo 4 (katër) vjet nga ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit, nëpërmjet ekspertëve ose organizatave me përvojë në këtë fushë.

5. Afati i zbatimit të programeve të përcaktuara në pikën 1, të kreut I, është 5 (pesë) vjet nga hyrja në fuqi.

6. Ngarkohet drejtori i Përgjithshëm i AKPA-së për miratimin e rregullores së zbatimit të programeve të nxitjes së punësimit, sipas pikës 1, të këtij kreu, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i shtetit "Zëri i nxitjes së punësimit" dhe nga fondi social i punësimit, pas krijimit të tij.

8. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 350, datë 29.4.2020

PËR TRANSFERIMIN E PRONËSISË SË 100% TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË "TRAJTIMI I STUDENTËVE", SH.A., SHKODËR, NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË TE BASHKIA SHKODËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995, "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", të ndryshuar, të neneve 3 e 4, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë "Trajtimi i studentëve", sh.a., Shkodër, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë te Bashkia Shkodër, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme dhe Bashkia Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 351, datë 29.4.2020

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2020, NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË DHE MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, bëhet rishpërndarja e fondeve, si më poshtë vijon:

a) Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në programin buxhetor "Menaxhimi i të ardhurave tatimore" 01140, i shtohet fondi prej 26 000 000 (njëzet e gjashtë milionë) lekësh në shpenzime kapitale, për projektin "Blerje shërbim automatizimi dhe monitorimi aktiviteti për inspektorët", me vlerë të plotë projekti 127 440 000 (njëqind e njëzet e shtatë milionë e katërqind e dyzet mijë) lekë.

b) Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në programin buxhetor "Transporti rrugor" 04520, i pakësohet fondi prej 26 000 000 (njëzet e gjashtë milionë) lekësh në shpenzime kapitale.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 353, datë 29.4.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.327, DATË 28.5.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E FORMATIT DHE MËNYRËS SË MBLEDHJES E TË RAPORTIMIT TË TË DHËNAVE NGA OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR, PUBLIK OSE PRIVAT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 2 e 3, të nenit 30, të ligjit nr.10107, datë 30.3.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të pikës 3, të nenit 59, të ligjit nr.10138, datë 11.5.2009, "Për shëndetin publik", të ndryshuar, dhe të nenit 12, të ligjit nr.17/2018, "Për statistikat zyrtare", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.327, datë 28.5.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 9 shfuqizohet.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

"1/1. Ofruesit e shërbimit të kujdesit shëndetësor, publik ose privat, raportojnë të dhëna në sistemin e informacionit shëndetësor, sipas përcaktimeve në vendimin nr.135, datë 20.3.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e nomenklaturës së klasifikimit ndërkombëtar të sëmundjeve, ICD-10".".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 354, datë 29.4.2020

PËR DHËNIEN E NDIHMËS ME PERSONEL INFERMIER PËR REPUBLIKËN E ITALISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 35, të ligjit nr.10107, datë 30.3.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të neneve 5 e 45, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e ndihmës me 60 vetë, personel infermier, në kushtet e pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, Republikës së Italisë.

2. Shpërblimi i infermierëve, që do të ofrojnë shërbim shëndetësor në Republikën e Italisë, është 2 500 (dy mijë e pesëqind) euro në muaj.

3. Fondi prej 19 000 000 (nëntëmbëdhjetë milionë) lekësh, për shpërblimin e personelit infermier, që do të ofrojnë shërbim shëndetësor në Republikën e Italisë, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2020.

4. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale që të bëjë përzgjedhjen e infermierëve të cilët do të ofrojnë shërbim shëndetësor në Republikën e Italisë.

5. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të sigurojnë transportin e personelit infermier drejt Italisë.

6. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 356, datë 26.2.2020

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E DREJTËSISË TE MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË, PËR NDËRMARRJEN INDUSTRIALE NR.1 TIRANË, TË PASURISË NR.1/645, ZONA KADASTRALE NR.8210, TIRANË, DHE MIRATIMIN E PROJEKTKONTRATËS SË SHITBLERJES SË PASURISË SË PALUAJTSHME NR.1/645/ND, ZONA KADASTRALE 8210, TIRANË, PËR QËLLIM TË ZBATIMIT TË PROGRAMIT TË INTEGRUAR TË ZHVILLIMIT "POLI I DREJTËSISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, të ligjit nr.88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, dhe në zbatim të pikës 5, të vendimit nr.234, datë 17.4.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për Programin e Integruar të Zhvillimit "Poli i Drejtësisë"", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Drejtësisë te Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për Ndërmarrjen Industriale Nr.1 Tiranë, të pasurisë së paluajtshme "truall", me numër pasurie nr.1/645/ND, në zonën kadastrale 8210, Tiranë, për ta përdorur për qëllimin e mirëfunksionimit të godinës me numër pasurie nr.1/645/ND, zona kadastrale 8210, Tiranë, ku do të zhvillojnë aktivitetin e tyre organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, në kuadër të zbatim të Programit të Integruar të Zhvillimit "Poli i Drejtësisë".

2. Miratimin e projektkontratës së shitblerjes së godinës me numër pasurie nr.1/645/ND, zona kadastrale 8210, Tiranë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi. Ndërmarrja Industriale Nr.1 Tiranë autorizohet të nënshkruajë kontratën e shitblerjes së godinës së sipërpërmendur, pas verifikimit të përputhshmërisë së saj me legjislacionin në fuqi mbi shitblerjen e pasurive të paluajtshme.

3. Autorizohet Ndërmarrja Industriale Nr.1 Tiranë t'i kalojë me kontratë huapërdorjeje, pa kundërshpërblim, Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Shkollës Kombëtare të Magjistraturës, mjediset e godinës me numër pasurie nr.1/645/ND, zona kadastrale 8210, Tiranë, sipas planimetrive që i bashkëlidhen këtij vendimi, pas kalimit të pronësisë, sipas të pikës 2, të këtij vendimi.

4. Ndërmarrja Industriale Nr.1 Tiranë kryen shërbimet e mirëmbajtjes së godinës dhe të truallit funksional. Shpenzimet e mirëmbajtjes mbulohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e institucioneve të përmendura në pikën 3, të këtij vendimi. Për fillimin e aktivitetit, Ndërmarrjes Industriale Nr.1 Tiranë i akordohen 5 000 000 (pesë milionë) lekë në formën e transfertës, të cilat përballohen nga buxheti i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, programi "Menaxhimi i shpenzimeve publike", miratuar për vitin 2020.

5. Vlera financiare e shitblerjes së godinës, me numër pasurie nr.1/645/ND, zona kadastrale 8210, Tiranë, paguhet sipas mënyrës së parashikuar në nenin 2, të projektkontratës. Për vitin 2020, kësti i pari i pagesës së godinës do të përballohet nga buxheti i vitit 2020, miratuar për Fondin Shqiptar të Zhvillimit, në programin "Projekte zhvillimi" dhe "100 Fshatrat" dhe do t'i transferohet Ndërmarrjes Nr.1, Tiranë.

6. Vendimi nr.670, datë 7.8.2013, i Këshillit të Ministrave, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Drejtësisë, për Dhomën Kombëtare të Avokatisë, të pasurisë së paluajtshme, me sipërfaqe 25 000 (njëzet e pesë mijë) m^2, me nr.1/190, në zonën kadastrale 8210, Tiranë, komponent i pronës nr.64, me emërtim "Ish-fusha e aviacionit", për ta përdorur për ndërtimin e Shkollës Kombëtare të Avokatisë", shfuqizohet.

7. Ngarkohen Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ndërmarrja Industriale Nr.1 Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr.16, datë 28.4.2020

PËR DHËNIEN E NDIHMËS ME PERSONEL INFERMIER PËR REPUBLIKËN E ITALISË

Në mbështetje të nenit 35, të ligjit nr.10107, datë 30.3.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të neneve 5 e 45, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr.88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, në vijim të vendimit nr.243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore", Komiteti Ndërministror i Emergjencave Civile, i mbledhur sot në datën 28.4.2020,

VENDOSI:

1. Propozomin për miratim në Këshillin e Ministrave të dhënies së ndihmës me 60 vetë, personel infermier, Republikës së Italisë, në kushtet e pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, sipas tekstit bashkëlidhur.

2. Shpërblimi i infermierëve, që do të ofrojnë shërbim shëndetësor në Republikën e Italisë, të jetë 2 500 (dy mijë e pesëqind) euro në muaj.

3. Fondi prej 19 000 000 (nëntëmbëdhjetë milionë) lekësh, për shpërblimin e personelit infermier, që do të ofrojnë shërbim shëndetësor në Republikën e Italisë, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2020.

4. Të ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale që të bëjë përzgjedhjen e infermierëve të cilët do të ofrojnë shërbim shëndetësor në Republikën e Italisë.

5. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të sigurojnë transportin e personelit infermier drejt Italisë.

6. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KOMITETIT
NDËRMINISTROR
TË EMERGJENCAVE CIVILE
KRYEMINISTËR
Edi Rama

PROJEKTVENDIM
"PËR DHËNIEN E NDIHMËS ME PERSONEL INFERMIER PËR REPUBLIKËN E ITALISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 35, të ligjit nr.10107, datë 30.3.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të neneve 5 e 45, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e ndihmës me 60 vetë, personel infermierë, në kushtet e pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, Republikës së Italisë.

2. Shpërblimi i infermierëve, që do të ofrojnë shërbim shëndetësor në Republikën e Italisë, është 2 500 (dy mijë e pesëqind) euro në muaj.

3. Fondi prej 19 000 000 (nëntëmbëdhjetë milionë) lekësh, për shpërblimin e personelit infermier, që do të ofrojnë shërbim shëndetësor në Republikën e Italisë, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2020.

4. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale që të bëjë përzgjedhjen e infermierëve të cilët do të ofrojnë shërbim shëndetësor në Republikën e Italisë.

5. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të sigurojnë transportin e personelit infermierë drejt Italisë.

6. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 140 lekë